



Rregullorja e Kancelares

Numri: **A-663**

Subjekti: Qasja në Gjuhë për Prindërit

Kategoria: NXËNËSIT

Lëshuar më: 20 qershor 2025

PËRMBLEDHJE E NDRYSHIMEVE

Kjo rregullore zëvendëson Rregulloren A-663 të Kancelares të datës 26 qershor 2009.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përshkruajë procedurat për të siguruar që prindërit e nxënësve të regjistruar në Shkollat Publike të Nju Jorkut (New York City Public Schools), përfshirë ata që komunikojnë në një gjuhë tjetër nga anglishtja, të kenë një mundësi domethënëse për të marrë pjesë dhe për të pasur qasje në programet dhe shërbimet thelbësore për arsimin e fëmijës së tyre. Pjesë të kësaj rregulloreje janë riorganizuar për më shumë qartësi dhe lehtësi në kuptim, dhe për të përditësuar lidhjet me burimet aktuale. Kjo rregullore gjithashtu është riemërtuar për të pasqyruar spektrin e plotë të shërbimeve të Qasjes në Gjuhë (Language Access) të disponueshme për prindërit. Përmbajtja e rregullores është modifikuar si më poshtë:

Ndryshime:

Seksioni I. Përkufizime

- Shtohet përkufizimi i termave kyç: DOE, Shkollë, Prind, Prind me njohuri të kufizuara të anglishtes (Limited English Proficient Parent), Fleta e Kontaktit për Emergjencë (Emergency Contact Card), Zyra e Qasjes në Gjuhë (Office of Language Access), Koordinatorit për Qasjen në Gjuhë (Language Access Coordinator) dhe Stafi i shkollës që ka kontakt me prindërit (Parent-facing School Staff).
- Përditësohen përkufizimet e termave kyç, përfshirë Interpretimi (Interpretation) dhe Përkthimi (Translation).
- Hiqen përkufizimet e termave të vjetruar.
- Gjuhët e mbuluara (Covered Languages) janë rritur në dymbëdhjetë gjuhët më të zakonshme të preferuara nga prindërit, përveç anglishtes, të identifikuara nga DOE.

Seksioni II. Përcaktimi i Gjuhës së Preferuar për Komunikim

- Zëvendëson referencat ndaj “gjuhës kryesore” me “gjuhën e preferuar,” në përputhje me praktikatat aktuale.
- Sqaron kërkesën që shkollat të mbajnë një evidencë të gjuhës së preferuar të çdo prindi dhe mënyrën se si ky informacion do të ruhet.
- Shton që informacioni mbi gjuhën e preferuar të prindërve duhet të jetë i aksesueshëm për stafin që ndërvepron me prindërit, përveç rasteve kur ndalohej nga ligji shtetëror apo federal në lidhje me të dhënat e nxënësve ose me urdhër gjykatë.

Seksioni III. Detyrimi për të Siguruar Shërbime të Ndihmës Gjuhësore

- Rishikon dhe riorganizon këtë seksion për më shumë qartësi.

- Sqaron kërkesën për të ofruar shërbime të Përkthimit (Translation) dhe Interpretimit (Interpretation).
- Përcakton Komunikimet Kritike (Critical Communications).

Seksioni IV. Shërbime të Ndhmës Gjuhësore përtej Kërkesave të Kësaj Rregulloreje

- Sqaron që DOE (Departamenti i Arsimit) mund të ofrojë shërbime të qasjes në gjuhë edhe përtej kërkesave të përcaktuara në këtë rregullore.

Seksioni V. Emërimi i Stafit të Shkollës si Koordinator i Qasjes në Gjuhë

- Shton kërkesën që çdo drejtor shkolle të caktojë një Koordinator për Qasjen në Gjuhë (Language Access Coordinator), i cili do të jetë përgjegjës për mbështetjen e shërbimeve të ndhmës gjuhësore brenda shkollës, dhe përshkruan detyrat e kësaj pozite.

Seksioni VI. Plani Shkollor për Përkthim dhe Interpretim Gjuhësor (LTI)

- Përditëson emrin e Planit LTI dhe listën e elementeve që duhet të përfshijë plani.
- Shton që DOE (Departamenti i Arsimit) do të rishikojë planin e çdo shkolle.

Seksioni VII. Trajnimi

- Shton kërkesën që i gjithë stafi shkollor që ndërvepron me prindërit të marrë trajnim mbi qasjen në gjuhë.
- Parashikon trajnime shtesë për Koordinatorët e Qasjes në Gjuhë (LACs – Language Access Coordinators).

Seksioni VIII. Si mund të Kërkojnë Prindërit Shërbime të Qasjes në Gjuhë

- Sqaron mënyrat se si prindërit mund të kërkojnë shërbime të qasjes në gjuhë.
- Përditëson informacionin e kontaktit për kërkimin e këtyre shërbimeve.

Seksioni IX. Njoftimi për Prindërit

- Sqaron përgjegjësinë e shkollave për t'u ofruar prindërve informacion mbi disponueshmërinë e shërbimeve të qasjes në gjuhë, përfshirë se si të përfitojnë nga këto shërbime dhe si të japin komente ose të paraqesin ankesa për to.

Seksioni X. Ruajtja e Regjistrimeve

- Sqaron kërkesat për ruajtjen e regjistrimeve.

Seksioni XI. Pyetje dhe Kërkesa për Informacion

- Përditëson informacionin aktual të kontaktit për pikën përkatëse të kontaktit ku mund të drejtohen pyetjet ose kërkesat.



Rregullorja e Kancelares

Numri: **A-663**

Subjekti: Qasja në Gjuhë për Prindërit

Kategoria: NXËNËSIT

Lëshuar më: 20 qershor 2025

PËRMBLEDHJE

Kjo rregullore zëvendëson Rregulloren A-663 të Kancelares të datës 26 qershor 2009. Ajo përcakton procedurat për të siguruar që prindërit e nxënësve të regjistruar në Shkollat Publike të Nju Jorkut (New York City Public Schools), përfshirë prindërit që komunikojnë në një gjuhë tjetër nga anglishtja, të kenë një mundësi domethënëse për të marrë pjesë dhe për të pasur qasje në programet dhe shërbimet që janë thelbësore për arsimin e fëmijës së tyre.

I. PËRKUFIZIME

Për qëllimet e kësaj rregulloreje:

- A. Gjuhët e mbuluara (Covered Languages) i referohen dymbëdhjetë gjuhëve më të zakonshme të preferuara nga prindërit, përveç anglishtes, të identifikuara nga DOE (Departamenti i Arsimit). Çdo gjuhë e re që do të shtohet si e mbuluar do të zbatohet në mënyrë graduale pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.¹
- B. DOE i referohet Departamentit të Arsimit të Nju Jorkut (NYC Department of Education).
- C. Fleta e Kontaktit për Emergjencë (Emergency Contact Card) i referohet një formulari të dorëzuar çdo vit nga prindërit, që përmban informacione të kontaktit për raste emergjente dhe gjuhën e preferuar të prindërve.
- D. Interpretimi (Interpretation) nënkupton procesin e përkthimit të komunikimit të folur nga një gjuhë në një komunikim të barasvlershëm të folur në një gjuhë tjetër, duke ruajtur saktësisht kuptimin, tonin dhe qëllimin e mesazhit origjinal.
- E. Koordinatori për Qasjen në Gjuhë (Language Access Coordinator – LAC) i referohet një punonjësi të caktuar të shkollës që është përgjegjës për mbështetjen e shërbimeve të ndihmës gjuhësore brenda shkollës.
- F. Shërbimet e ndihmës gjuhësore (Language assistance services) nënkuptojnë përkthim dhe/ose interpretim për prindërit me njohuri të kufizuara të anglishtes.
- G. Prindi me njohuri të kufizuara të anglishtes (Limited English Proficient – LEP Parent) i referohet një prindi që nuk flet anglisht si gjuhë primare dhe/ose që e përshkruan veten si me aftësi të kufizuara për të lexuar, folur, shkruar ose kuptuar anglishten dhe/ose që preferon të komunikojë në një gjuhë tjetër përveç anglishtes.

¹ Versioni i mëparshëm i kësaj rregulloreje, i lëshuar më 26 qershor 2009, e përkufizonte gjuhët e mbuluara si "nëntë gjuhët më të zakonshme kryesore përveç anglishtes të folura nga banorët e Nju Jorkut, siç janë identifikuar nga Departamenti i Arsimit."

- H. Zyra për Qasjen në Gjuhë (Office of Language Access – OLA), dhe çdo pasuese e saj, i referohet zyrës brenda DOE (Departamenti i Arsimit) që ofron dhe mbikëqyr shërbimet e ndihmës gjuhësore.
- I. Prind (Parent) i referohet prindit ose kujdestarit të fëmijës, ose çdo personi në marrëdhënie prindërore apo kujdestarie me fëmijën. Kjo përfshin: prindin biologjik ose birësues, njerkun/njerkën, kujdestarin e emëruar ligjrisht, prindin kujdestar dhe “personin në marrëdhënie prindërore” me një fëmijë që ndjek shkollën. “Person në marrëdhënie prindërore” i referohet një personi që ka marrë përsipër kujdesin për një fëmijë sepse prindërit ose kujdestarët ligjorë të fëmijës nuk janë të disponueshëm, përfshirë (por jo vetëm) për shkak të vdekjes, burgimit, sëmundjes mendore, jetesës jashtë shtetit apo braktisjes së fëmijës.
- J. Staf shkollor që ndërvepron me prindërit (Parent-Facing School Staff) nënkupton mbikëqyrësit e shkollës, stafin mbështetës të shkollës (p.sh. sekretarë, nëpunës apo tituj të tjerë administrativë), infermierët e Zyrës së Shëndetit të Shkollës (Office of School Health) që janë të bazuar në shkollë, koordinatorë, ndihmës ose bashkëpunëtorë komunitarë, punonjës familjarë, këshilltarë shkollorë, punonjës socialë shkollorë, psikologë shkollorë, mësues dhe ndihmës mësues — të gjithë ata që ka gjasa të ndërveprojnë me prindërit LEP (me njohuri të kufizuara të anglishtes).
- K. Shkollë (School) i referohet një shkolle brenda distriktit të shkollave të NYC.
- L. Përkthimi (Translation) nënkupton procesin e konvertimit të një teksti të shkruar nga një gjuhë në një tekst të barasvlershëm të shkruar në një gjuhë tjetër, duke ruajtur saktësisht kuptimin, tonin dhe qëllimin e përmbajtjes origjinale.

II. PËRCAKTIMI I GJUHËS SË PREFERUAR PËR KOMUNIKIM

- A. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga regjistrimi i një nxënësi, shkollat duhet të përcaktojnë gjuhët e preferuara për komunikim me shkrim dhe me gojë të prindërve të çdo nxënësi të regjistruar në shkollë.
- B. Shkollat duhet të mbajnë një regjistër të saktë dhe të përditësuar të gjuhëve të preferuara të çdo prindi, dhe ky informacion duhet të jetë i aksesueshëm për stafin shkollor që ndërvepron me prindin. Ky informacion duhet të ruhet në bazën e të dhënave Automate the Schools (ATS), në Fletën e Kontaktit për Emergjencë të nxënësit, në Profili i Nxënësit (Student Profile) – një aplikacion online që ofron informacion mbi nxënësit për stafin shkollor – ose në çdo bazë të dhënash, dokument apo aplikacion pasues. Prindërve duhet t’u jepet mundësia të përditësojnë gjuhën e tyre të preferuar në Fletën e Kontaktit për Emergjencë ose në një formular të ngjashëm. Shkollat duhet të përditësojnë ATS-in ose çdo bazë të dhënash pasuese në përputhje me ndryshimet.
- C. Informacioni për gjuhën e preferuar të prindërve duhet të jetë i aksesueshëm për stafin që ndërvepron me ta, përveç rasteve kur kjo ndalohet nga ligji shtetëror apo federal në lidhje me privatësinë e të dhënave të nxënësit ose nga ndonjë urdhër gjykatë.

III. DETYRIMI PËR TË SIGURUAR SHËRBIME TË NDIHMËS GJUHËSORE

- A. Përkthimi i Komunikimeve Kritike në Gjuhët e Mbuluara
 - a. Komunikimet Kritike janë komunikime që lidhen me regjistrimin, standardet akademike, programet, ngjarjet e hapura për prindërit, mbylljet e shkollave, shëndetin, sigurinë, çështjet ligjore ose disiplinore, dhe të drejtën për arsim publik.

- i. DOE do të identifikojë dhe përkthejë në Gjuhët e Mbuluara Komunikimet Kritike me shkrim që nuk janë të lidhura me një nxënës specifik, siç janë formularët e krijuar në mënyrë qendrore, kalendarët akademikë dhe udhëzuesit për prindër, të cilat shpërndahen ose komunikohen në mënyrë elektronike për të gjithë, ose për pjesën më të madhe të prindërve të nxënësve brenda shkollës(ave) ose klasës(ave). Në masën e mundshme, përkthimet do të shpërndahen në të njëjtën kohë ose afërsisht në të njëjtën kohë me versionet në anglisht. Nëse përkthimi nuk është i disponueshëm menjëherë, DOE do të sigurojë, me kërkesë, një përkthim sa më shpejt të jetë e mundur, me kusht që dokumenti të mbetet i rëndësishëm.
- ii. Në rrethana urgjente, si p.sh. evakuimi emergjent i një ndërtese shkollore, kur një shkollë nuk mund të dërgojë menjëherë një përkthim të komunikimeve për ato rrethana, shkolla do të sigurojë, sa më shpejt të jetë e mundur, një komunikim përmes përkthimit ose interpretimit në gjuhën e preferuar të prindit, e cila mund të jetë një gjuhë që nuk është e mbuluar, duke ofruar informacion mbi rrethanat emergjente.
- iii. Për Komunikimet Kritike me shkrim që lidhen me nxënës të veçantë, siç janë Programet e Arsimit të Personalizuar (Individualized Education Programs - IEPs), Planet sipas Nenit 504 dhe raportet e vlerësimit të nxënësit, DOE do të ofrojë, me kërkesë, përkthim për prindërit LEP që kanë si gjuhë të preferuar një nga Gjuhët e Mbuluara, dhe, në masën e mundshme, për prindërit që kanë si gjuhë të preferuar një gjuhë që nuk është e mbuluar.
- iv. Shkollat do të ofrojnë përkthime të Komunikimeve Kritike me shkrim që lidhen me nxënës të veçantë në Gjuhët e Mbuluara që nuk ofrohen nga OLA.

B. Interpretimi (Përkthimi):

- a. DOE do të ofrojë shërbime interpretimi në takimet e mëposhtme në nivel qyteti/distrikti në Gjuhët e Mbuluara që DOE parashikon të jenë gjuhët më të zakonshme të preferuara nga prindërit LEP që marrin pjesë:
 - i. Takimet e Panelit për Politikën Arsimore
 - ii. Takimet e Këshillave Arsimorë të Qytetit/Komunitetit
 - iii. Takimet e prindërve në nivel qyteti të organizuara nga zyrat qendrore
 - iv. Takimet e Ekipit Drejtues të Rrethit dhe ngjarjet për prindër të organizuara nga Zyrat e Rrethit
- b. DOE do të ofrojë shërbime interpretimi për prindërit LEP që kanë si gjuhë të preferuar një nga Gjuhët e Mbuluara dhe që kërkojnë këto shërbime për të komunikuar me stafin e DOE në lidhje me Komunikime Kritike që lidhen me arsimin e fëmijës së tyre, përfshirë, por jo të kufizuara në, takimet mësues-prind, seancat dëgjimore për pezullime, takimet për arsimin e posaçëm, takimet vjetore mësues-prind për Nxënësit që Mësojnë Gjuhën Angleze dhe takimet sipas Nenit 504.

- c. Në masën më të madhe të mundshme, DOE do të ofrojë shërbime interpretimi edhe në gjuhë që nuk janë të mbuluara.
- d. Interpretimi mund të ofrohet në vend, aty ku prindi po kërkon të komunikojë, virtualisht ose përmes telefonit, në varësi të mundësisë.
- e. Prindërit LEP mund të zgjedhin të mbështeten në një mik/shoqërues të rritur apo të afërm për shërbime interpretimi.
- f. Nxënësit dhe fëmijët e tjerë (të mitur nën moshën 18 vjeç) nuk mund të shërbejnë si përkthyes për stafin e DOE dhe prindërit LEP gjatë takimeve për arsimin e posaçëm apo në ndonjë takim formal ose joformal ku diskutohen arritjet dhe/ose sjellja e nxënësit.

IV. SHËRBIME TË NDIHMËS GJUHËSORE PËRTEJ KËRKESAVE TË KËSAJ RREGULLOREJE

- A. DOE mund të ofrojë përkthim të teksteve për komunikime audio ose video në Gjuhët e Mbuluara.
- B. DOE mund të ofrojë shërbime përkthimi dhe interpretimi përtej atyre të përshkruara në këtë rregullore, përfshirë edhe gjuhë që nuk janë të mbuluara.

V. ÇAKTIMI I STAFIT SHKOLLOR SI KOORDINATOR PËR QASJEN NË GJUHË

- A. Në fillim të çdo viti shkollor, çdo drejtor shkolle do të caktojë të paktën një anëtar të stafit për të shërbyer si Koordinator për Qasjen në Gjuhë (Language Access Coordinator – LAC), i cili do të jetë përgjegjës për mbështetjen e shërbimeve të ndihmës gjuhësore brenda shkollës. LAC duhet të jetë një zëvendës drejtor ose një administrator tjetër i shkollës që ka njohuri mbi funksionimin e përgjithshëm të shkollës, strategjinë e komunikimit me prindërit dhe aftësinë për të përcjellë informacionin te stafi i shkollës. Detyrat e LAC do të përfshijnë:
 - a. Përçimin e informacionit për burimet dhe përditësimet mbi mbështetjet në dispozicion të pjesa tjetër e stafit të shkollës.
 - b. Asistimin me pyetjet dhe shqetësimet e prindërve që lidhen me shërbimet e ndihmës gjuhësore.
 - c. Njohjen me strategjinë e komunikimit të shkollës për t'u lidhur me prindërit (komunikimet me shkrim dhe ngjarjet për prindër).
 - d. Të jetë në dijeni të nevojave gjuhësore të prindërve të shkollës.
 - e. Të ofrojë udhëzime gjatë hartimit të Planit të Përkthimit dhe Interpretimit Gjuhësor (LTI) të shkollës brenda Planit Gjithëpërfshirës Arsimor (Comprehensive Education Plan – CEP).
 - f. Të ofrojë udhëzime mbi mënyrën e përdorimit të fondeve për Shërbimet e Përkthimit dhe Interpretimit, të cilat shpërndahen çdo vit në shkollë përmes Memorandumit të Alokimit për Shkollën (School Allocation Memorandum).
 - g. Të jetë në dijeni të shqetësimeve në lidhje me shërbimet e ndihmës gjuhësore dhe të ndihmojë në trajtimin e këtyre shqetësimeve.
- B. LAC-at duhet të trajtohen në përputhje me Seksionin VII të kësaj rregulloreje.

VI. PLANI SHKOLLOR PËR PËRKTHIM DHE INTERPRETIM GJUHËSOR (LTI)

- A. Si pjesë e CEP-së së saj, çdo shkollë duhet të rishikojë dhe plotësojë Planin vjetor LTI për të adresuar nevojat e saj për ndihmë gjuhësore, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje. Planin LTI kërkon informacion mbi sa vijon:
 - a. Emri i personit të caktuar si LAC.
 - b. Identifikimi dhe vlerësimi i grupit të prindërve LEP.
 - c. Identifikimi i Komunikimeve Kritike me shkrim dhe i takimeve ballë për ballë gjatë gjithë vitit shkollor që kërkojnë shërbime të ndihmës gjuhësore dhe mënyra se si shkolla planifikon të përgjigjet ndaj këtyre nevojave.
 - d. Planin për të siguruar ndërgjegjësimin e stafit mbi kërkesat për qasje në gjuhë dhe mbi burimet e disponueshme.
 - e. Sigurimi i njoftimit për prindërit mbi shërbimet e ndihmës gjuhësore të disponueshme.
 - f. Metodën që shkolla do të përdorë për të kërkuar dhe zbatuar komente për ofrimin e saj të shërbimeve të ndihmës gjuhësore.
- B. Pasi një shkollë dorëzon Planin LTI të plotësuar, ky plan do të rishikohet nga DOE në përputhje me afatet e përcaktuara për rishikimin dhe finalizimin e CEP-së.

VII. TRAJNIMI

- A. Çdo drejtor shkolle duhet të sigurojë që Stafi i Shkollës që Ndërvepron me Prindërit të përfundojë trajnimin për qasje në gjuhë të zhvilluar nga OLA, në periudha të caktuara nga DOE, të cilat duhet të jenë të paktën çdo dy vjet, mbi politikat dhe procedurat e përcaktuara në këtë rregullore, si edhe mbi përgjegjësitë e stafit për qasjen në gjuhë, mbështetjet e disponueshme për stafin e shkollës, udhëzimet për praktikën më të mira dhe standardet etike të veprimit.
- B. Për më tepër, DOE do të ofrojë trajnim shtesë për LAC-at, të zhvilluar nga OLA, të paktën çdo dy vjet.

VIII. SI MUND TË KËRKOJNË PRINDËRIT SHËRBIME TË NDIHMËS GJUHËSORE

Prindërit që dëshirojnë të marrin shërbime të ndihmës gjuhësore duhet të:

- A. Kontaktojnë drejtorin e shkollës së fëmijës së tyre ose koordinatoren për prindërit,
- B. Telefonojnë DOE në numrin 718-935-2013, ose
- C. Vizitojnë faqen schools.nyc.gov/hello për të aksesuar Formularin e Kërkesës për Shërbime të Përkthimit dhe Interpretimit.

IX. NJOFTIMI PËR PRINDËRIT

- A. Faqja e internetit e DOE do të ofrojë informacion në secilën nga Gjuhët e Mbuluara lidhur me të drejtat e prindërve për shërbime të ndihmës gjuhësore dhe mënyrën se si mund t'i aksesojnë këto shërbime dhe të japin komente mbi to.

- B. Shkollat janë përgjegjëse që çdo vit t'i ofrojnë çdo prindi, në mënyrë elektronike ose ndryshe, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, informacion mbi disponueshmërinë e shërbimeve falas të përkthimit dhe interpretimit, duke përfshirë:
 - a. Si të aksesojnë ose të marrin këto shërbime; dhe
 - b. Si të japin komente për këto shërbime, përfshirë vështirësitë në marrjen e tyre dhe mënyrën e paraqitjes së një kërkesë për informacion ose ankese.
- C. Shkollat, si dhe zyrat që takohen rregullisht me prindër, janë përgjegjëse që çdo vit të afishojnë, në një vend të dukshëm në ose pranë hyrjes kryesore të asaj shkolle apo zyre, një poster në secilën nga Gjuhët e Mbuluara që tregon disponueshmërinë e shërbimeve të ndihmës gjuhësore. OLA do të shpërndajë postera të përkthyer në Gjuhët e Mbuluara në fillim të vitit shkollor. Posterat janë gjithashtu të disponueshëm për stafin në <https://infohub.nyced.org/nyc-doe-topics/office-of-language-access/translation-resources>.
- D. Çdo shkollë ku më shumë se 10% e prindërve të nxënësve flasin një gjuhë të preferuar që nuk është as anglishtja dhe as një nga Gjuhët e Mbuluara, duhet të marrë nga OLA përkthimin e materialeve të kërkuara sipas këtij seksioni në atë gjuhë dhe t'i afishojë dhe shpërndajë këto materiale në përputhje me këtë seksion.
- E. Plani i sigurisë i çdo shkolle duhet të parashikojë që prindërit që kanë nevojë për shërbime ndihme gjuhësore të marrin mbështetje interpretimi për të komunikuar me stafin e shkollës dhe duhet të përmbajë procedura për të siguruar që prindërit LEP të mund të gjejnë zyrën administrative të shkollës dhe të komunikojnë me administratorët.

X. RUAJTJA E TË DHËNAVE

- A. OLA (Zyra për Qasjen në Gjuhë) do të ruajë këto të dhëna:
 - a. Numrin e dokumenteve të veçanta të përkthyer nga stafi i saj ose nga ofrues të jashtëm të kontraktuar nga DOE dhe natyrën e përgjithshme të këtyre dokumenteve.
 - b. Numrin e takimeve dhe telefonatave në të cilat janë ofruar shërbime interpretimi përmes një ofruesi të kontraktuar, si dhe gjuhët për të cilat janë ofruar këto shërbime.
 - c. Dokumentacionin lidhur me buxhetin vjetor për shërbimet e ndihmës gjuhësore.
 - d. Numrin e punonjësve të DOE që ofrojnë shërbime për qasje në gjuhë me kohë të plotë.

XI. PYETJE DHE KËRKESA PËR INFORMACION

Për pyetje, komente, ankese ose ndihmë lidhur me këtë rregullore, kontaktoni:

Zyra për Qasjen në Gjuhë (Office of Language Access)
 Departamenti i Arsimit i NYC (NYC Department of Education)
 28-11 Queens Plaza North – Kati i 4-t
 Long Island City, NY 11101
 Vizitoni schools.nyc.gov/hello